270	19449	15.05.2009	Maliq	Shehu	Ibrahim	Aneme	01.02.1933	Gjirokastër	M	2 vjet 11 muaj 24 dite	2,190,000	0	200,000	0	0	1,990,000
271	19532	18.05.2009	Ismail	Gremi	Bektash	Nasibe	15.02.1899	Radovickë	M	14 vjet, 3 muaj, 18 dite	10,442,000	200,000	1,700,000	0	0	8,542,000
272	19550	19.05.2009	Donat	Kurti	Kole	Age	09.09.1903	Shkoder	M	16 vjet 5 muaj 28 dite	12,046,000	0	1,979,836	0	0	10,066,164
273	19601	21.05.2009	Skënder	Shkupi	Mehmet	Lutfe	12.10.1920	Shkup	M	12 vjet 8 muaj 26 dite	9,308,000	200,000	0	0	0	9,108,000
274	19648	25.05.2009	Rrok	Vasa	Simon	Makë	10.08.1920	Shkodër	M	2 v 0 m 24 d (D1): 8 v D2)	7,352,000	0	501,483	0	0	6,850,517
275	19823	02.06.2009	Haxhi	Nikoçi	Avdi	Hyrë	23.03.1925	Tropoje	M	11 vjet 11 muaj 2 dite	8,716,000	0	1,500,000	0	0	7,216,000
276	19841	02.06.2009	Nush	Tukja	Kolë	Nushë	06.07.1920	Shkoder	M	13 vjet 3 muaj 28 dite	9,732,000	200,000	1,397,965	0	0	8,134,035
277	20104	12.06.2009	Osman	Gazepi	Kasem	Kado	07.04.1885	Leskovik	M	2191 dite	4,382,000	0	840,000	0	0	3,542,000
278	20168	16.06.2009	Xhevahir	Mollasi	Nevruz	Feruze	ska	Skrapar	M	Ivit 27 dite	784,000	200,000	25,659	0	0	558,341
279	20171	16.06.2009	Agron	Xhelili	Tasim	Farije	14.12.1935	Delvine	M	16 vjet, 1 muaj, 7 dite	11,756,000	200,000	1,733,479	0	0	9,822,521
280	20199	17.06.2009	Mehmet	Koshena	Ali	Naze	10.01.1900	Dukat	M	14 vjet 10 muaj 17 dite	10,874,000	200,000	1,933,015	0	0	8,740,985
281	20304	22.06.2009	Hysen	Hodoku	Elmas	Merjeme	30.08.1872	Pavar-Permet	M	1 vit 0 muaj 0 dite	730,000	0	119,103	0	0	610,897
282	20344	22.06.2009	Zenel	Kazazi	Muharrem	Hamide	15.09.1909	Shkoder	M	17 vjet, 2 muaj, 11 dite	12,556,000	100,000	2,000,000	0	0	10,456,000
283	20365	22.06.2009	Shaziman	Kishta	Myslim	Selvi	01.10.1920	Gramsh	M	3 vjet, 3 muaj, 0 dite	2,376,000	150,000	350,000	0	0	1,876,000
284	20424	24.06.2009	Vladimir	Terolli	Jani	Dhoksia	20.12.1955	Vuno-Vlorë	M	4 v 8 m 17 d	3,450,000	0	564,677	0	0	2,885,323
285	20501	25.06.2009	Veli	Strugu	Mehmet	Zyba	15.06.1886	Elbasan	M	1 vit, 3 muaj, 23 dite	962,000	50,000	0	0	0	912,000
286	20579	25.06.2009	Bernard	Ashiku	Koli	Kushe	12.07.1914	Shkoder	M	7 vjet 8 muaj 12 dite	5,630,000	200,000	800,000	0	0	4,630,000
287	20613	26.06.2009	Hysni	Mala	Veli	Qerime	28.03.1918	Tepelene	M	9 vjet 7 muaj 10 dite	7,024,000	0	1,154,630	0	0	5,869,370
288	20685	29.06.2009	Tom	Ndoja	Kol	Zoje	05.01.1952	Shkoder	M	6 vjet, 2 muaj, 13 dite	4,286,000	200,000	730,000	0	0	3,356,000
289	20780	29.06.2009	Kole	Dajani	Luke	Dile	13.05.1952	Shkoder	M	1568 dite	3,136,000	0	520,000	0	0	2,616,000
290	20859	30.06.2009	Hasan	Shehu	Rexhep	Kade	10.08.1922	Diber	M	6vjet 7 muaj 19 dite	3,640,000	200,000	696,274	0	0	2,743,726
291	21004	01.07.2009	Dhimitraq	Kume	Petro	Ana	20.09.1941	Sallbeg	M	10 vjet 1 dite	6,085,000	986	1,000,000	0	0	5,084,014
292	21023	08.05.2009	Nikoll	Papaj	Kole	Mara	12.04.1925	Shkodër	M	1 vit 1 muaj 29 dite	850,000	0	0	0	0	850,000
293	21106	01.07.2008	Sulo	Sulka	Demir	Rabie	02.01.1917	Kozare	M	4 v 8 m 14 d	3,444,000	0	564,822	0	0	2,879,178
294	21118	01.07.2009	Gjon	Kokaj	Ujk	Ndoce	05.12.1907	Shkoder	M	11 vjet 10 muaj 22 dite	8,694,000	0	1,424,980	0	0	7,269,020
295	21152	01.07.2009	Ramiz	Dema	Hysen	Zare	10.11.1913	Tirane	M	11 muaj, 5 dite	692,000	0	0	0	0	692,000
296	21180	01.07.2009	Gjin	Kulla	Ndue	Prende	12.07.1917	Lezhe	M	7 vjet 4 muaj 7 dite	4,476,000	0	840,000	0	0	3,636,000
297	11088/a	12.06.2008	Reis	Hasho	Ali	Sadika	18.07.1924	Gjirokastër	M	16 vjet 10 muaj 13 dite	12,326,000	200,000	1,825,250	0	0	10,300,750
298	15507	19.11.2008	Hashim	Xhoka	Jusuf	Zahide	03.05.1943	Dibër	M	9 vjet 1 muaj 10 dite	6,652,000	0	1,093,200	0	0	5,558,800

1,153,042,743

ANEKSI B

Lista nr. 18 e ish të dënuarve, të cilët janë dënuar me dënim kapital

Nr.	Nr. Dosjes	Data e dosjes individuale	Emër	Mbiemër	Atësi	Amësi	Datëlindja	Vendlindja	Gjinia	Viti i vdekjes	Shuma e dëmshtëpërblimit në lekë	Përfitimet nga ligje të mëparshme				Dëmshtëpërblimi përfundimtar
												Ministria e Financës		Enti Kombëtar i Banesave	Z.Q.R.P. P	
												Lekë	Leva më Vlerë			
1	327	12.02.2008	Jorgo	Lezo	Andon	Evdhoksia	31.03.1935	Sarandë	M	1958	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
2	1922	27.02.2008	Preng	Piroli	Ndrec	Mrikë	02.03.1903	Krujë	M	1950	5,840,000	300,000	720,000	0	0	4,820,000
3	2253	03.03.2008	Luigj	Palolaj(Jaku)	Pashuk	Prendë	28.06.1916	Kukës	M	25.08.1958	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
4	2274	03.03.2008	Bajram	Hamataj	Kamber	Salushe	06.03.1894	Tepelenë	M	10.07.1949	5,840,000	200,000	720,000	1,746,157	0	3,173,843
5	3407	11.03.2008	Sadik	Zagora	Mëmë	Laje	21.11.1902	Shkodër	M	1945	5,840,000	0	143,712	0	0	5,696,288
6	4879	27.03.2008	Ndrec	Bardhi	Nikoll	Dil	15.08.1906	Lezhe	M	19.05.1946	5,840,000	200,000	720,000	580,000	0	4,340,000
7	4991	01.04.2008	Hamdi	Mustafa	Hajir	Najife	07.01.1908	Ceprat	M	22.06.1945	5,840,000	100,000	280,000	968,000	0	4,492,000
8	5065	02.04.2008	Mydin	Saliko	Abedin	Feruze	20.05.1926	Kaduç	M	1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
9	6664	04.04.2008	Jorgji	Daja	Naun	Kostandinë	25.04.1930	Lushnje	M	1951	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
10	7814	17.04.2008	Abdulla	Kazazi	Ali	Sheje	05.02.1884	Shkodër	M	1948	5,840,000	200,000	760,000	700,000	0	4,180,000
11	7917	18.04.2008	Shaban	Lezemerja	Fejzulla	Xhume	01.02.1917	Muzhaqë	M	1951	5,840,000	200,000	720,000	0	250,000	4,670,000
12	8448	25.04.2008	Nikoll	Dashi	Boce	Pashkë	Nuk rezulton	Shkodër	M	1945	5,840,000	200,000	0	0	0	5,640,000
13	9410	13.02.2008	Ndrec	Doda	Dodë	Age	08.09.1916	Shkodër	M	24.01.1947	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
14	9527	14.05.2008	Loni	Adam	Adam	Ana	17.05.1910	Progër	M	06.06.1947	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
15	9833	19.05.2008	Preng	Marku	Kol	Dilë	05.05.1912	Mirditë	M	1955	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
16	10381	29.05.2008	Qemal	Doda	Shëfqet	Nuriye	15.01.1950	Librazhd	M	22.02.1974	5,840,000	0	0	0	0	5,840,000
17	11037	11.06.2008	Tasin	Bonjakaj	Halil	Mysade	ska	s'ka	M	s'ka	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
18	12098	08.07.2008	Abdul	Dalla	Resul	Mino	25.10.1911	Sarandë	M	30.05.1961	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
19	12280	14.07.2008	Xheladin	Begolli	Nazif	Naxhiye	15.07.1906	Peje	M	20.12.1951	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
20	13703	11.09.2008	Theodharaq	Fara(Faro)	Kristo	Katerina	12.01.1916	Sarandë	M	23.12.1963	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
21	14131	26.09.2008	Dedë	Gjoka	Gjokë	Lenë	05.11.1890	Hajmel	M	27.03.1952	5,840,000	200,000	718,560	0	0	4,921,440
22	14837	28.10.2008	Ramiz	Osmani	Qerim	Hasime	10.07.1904	Kosovë	M	19.03.1946	5,840,000	300,000	720,000	0	0	4,820,000
23	15217	10.11.2008	Jani	Zbogo	Foti	Dhiamando	14.11.1911	Vlorë	M	22.03.1951	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
24	16131	09.12.2008	Llazi	Mato	Dhori	Kostandina	23.01.1926	Pogradec	M	02.07.1979	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
25	16710	18.12.2008	Ismail	Tatzati	Haki	Hadije	12.02.1874	Delvinë	M	1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
26	17109	29.12.2008	Llambi	Petraj(Ziçishti)	Petro	Julja	13.12.1923	Korçë	M	01.09.1983	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
27	18182	08.05.2008	Bato	Salihani	Halim	Nasibe	0/0/1899	Dushar	M	04.07.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
28	18363	08.05.2009	Ibrahim	Aga	Adem	Xhemile	10.02.1911	Farke	M	16.07.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
29	19096	08.05.2009	Hysen	Çobo	Isa	Asime	07.05.1889	Vlorë	M	1945	5,840,000	250,000	960,000	0	0	4,630,000
30	19388	08.05.2009	Lazder	Lleshaj	Gjon	Mare	30.09.1910	Kruje	M	1946	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
31	19479	18.05.2009	Nevrus	Bylykbashi	Dervish	Aishe	1903	Pilur, Korce	M	19.08.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
32	19603	20.5.2009	Pavlo	Qendro	Koco	Vasillo	03.12.1927	Gjirokaster	M	16.04.1949	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
33	19633	22.05.2009	Sulo	Hitaj	Celo	Xhevo	05.08.1920	Bolene	M	12.09.1946	5,840,000	200,000	718,560	0	0	4,921,440
34	19659	25.05.2009	Kamber	Mezo (Meto)	Sade	Qabire	02.08.1927	Dërsnik	M	30.10.1945	5,840,000	250,000	720,000	0	0	4,870,000
35	19747	28.05.2009	Kolë	Prendi	Zef	Rozë	11.08.1910	Shkodër	M	07.06.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
36	19903	04.06.2009	Bektash	Shkëmbi	Nexhip	Haxhire	15.04.1890	Përmet	M	29.09.1969	5,840,000	0	0	1,107,690	0	4,732,310
37	20334	22.06.2009	Selim	Voci	Baftjar	Alemshah	10.02.1920	Elbasan	M	28.08.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
38	20748	29.06.2009	Dik	Cami	Mehmet	Sofije	s'ka	Diber	M	14.04.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
39	20914	30.06.2009	Ded	Malaj	Keq	Lule	16.11.1920	Selce	M	12.05.1959	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000

189,827,321

ANEKSI C

Lista nr. 18 e ish te denuareve te cilet kane vlerën 0

Nr.	Nr. Dosjes	Data e dosjes individuale	Emër	Mbiemër	Atësi	Amësi	Datëlindja	Vendlindja	Gjinia	Periodha e plotë e vuajtjes së dënimit	Shuma e dëmshpërblimit në lekë	Përfitimet nga ligje të mëparshme				Dëmshpërblimi përfundimtar
												Ministria e Finacës		Enti Kombëtar i Banesave	Z.Q.R.P.P	
												Lekë	Letra me Vlerë			
1	1096	18.02.2008	Sulo	Ferlushkaj	Cuf	Pashe	26.05.1890	Tuz	M	0 vjet 1 muaj 13 ditë	88,000	200,000	0	0	0	0
2	9213	09.05.2008	Keq	Kartoçi	Hazir	Gjylce	05.01.1910	Tropoje	M	231 dite	462,000	0	104,219	1,242,550	0	0
3	10443	29.05.2008	Nikoll	Tuci	Mark	Prendë	12.06.1884	Mirditë	M	1 vit 5 muaj 16 ditë	1,072.000	0	1,319,342	0	0	0
4	13933	19.09.2008	Aishe	Gokaj	Medo	Zepe	08.03.1920	Shkodër	F	0vjet,6muaj,15ditë	402 000	65 425	718 560	0	0	0
5	15197	10.11.2008	Gjon	Kola	Dedosh	Mare	05.02.1924	Shkodër	M	5 muaj, 24 ditë	358,000	60,000	500,000	0	0	0
6	16741	18.12.2008	Ibrahim	Doçi	Rexhe	Azize	03.08.1921	Tropoje	M	82 dite	164,000	262,590	219,833	0	0	0

VENDIM
Nr.364, datë 4.5.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË VLERËS MINIMALE TË SIPËRFAQES SË ZONËS
SË LEJUAR MINERARE DHE TË VLERËS MINIMALE TË INVESTIMIT E TË PRODHIMIT
PËR NJË LEJE MINERARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pikat 3 e 8, dhe 56, pika 1 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimi i kriterëve për vlerën minimale të sipërfaqes të zonës së lejuar minerare dhe për vlerën minimale të investimit për lejet minerare të kërkim-zbulimit ka karakter teknik, ekonomiko-financiar, dhe mbështetet në:

- a) përcaktimin e sipërfaqeve të mjaftueshme të zonës së lejuar minerare, për gjetjen e rezervave minerare për aktivitete të mëtejshme shfrytëzimi dhe përpunimi të mineralit;
- b) interesin për llojin e mineralit sipas grupeve të mineraleve;
- c) moscopëtimin e territoreve me strukturë të njëjtë gjeologo-minerare;
- ç) rregullat teknike të realizimit të aktivitetit të kërkim-zbulimit;
- d) mundësinë e gjetjes së rezervave të reja minerare;
- dh) leverdinë ekonomike të prodhimit të produkteve të gatshme për një vendburim të madh, grup vendburimesh të mesme e të vogla apo shfaqjesh minerale në një zonë të lejuar të kërkim-zbulimit;
- e) përfshirjen për aktivitet kërkim-zbulimi të kapitaleve të mjaftueshme financiare dhe profesionale;
- ë) realizimin e investimit në përputhje me objektivat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe planifikimin e territorit;
- f) krijimin e mundësive për rivlerësim të vendburimeve dhe objekteve të njohura.

2. Vlera minimale e sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe vlera minimale e investimeve për çdo kilometër katror të kësaj zone për lejet e kërkim-zbulimit, sipas grupeve të mineraleve, jepen në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Kriteret për vlerën minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare, vlerës minimale të investimit dhe vlerës minimale të prodhimit vjetor për lejet minerare të shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit kanë karakter teknik, ekonomiko-financiar dhe mbështeten në:

- a) përcaktimin e sipërfaqeve të mjaftueshme të zonës së lejuar minerare, për zhvillimin normal të aktiviteteve të shfrytëzimit dhe përpunimit të mineralit;
- b) kushtet e vendndodhjes, ndërtimin gjeologjik të objektit apo vendburimit;
- c) parametrat sasiorë dhe cilësorë të objektit apo vendburimit, përmasat e trupave minerarë apo vendburimit dhe marrëdhëniet e tij me elementet e infrastrukturës;
- ç) rregullat teknike të realizimit të aktivitetit të shfrytëzimit;
- d) investimet e nevojshme për realizimin e programit të prodhimit dhe të të gjitha punimeve e proceseve të nevojshme dhe që kushtëzohen nga kriteret tekniko-minerare;
- dh) kostot, çmimet, të ardhurat e pritshme dhe leverdinë ekonomike të prodhimit të produkteve të gatshme për një trup minerar apo vendburim të një zone të lejuar minerare;
- e) përfshirjen për aktivitet shfrytëzimi të kapitaleve të mjaftueshme financiare dhe profesionale;

ë) realizimin e investimit në përputhje me objektivat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe planifikimin e territorit;

f) konkurrueshmërinë e aktivitetit të shfrytëzimit me kushtet e tregut të brendshëm, rajonal apo ndërkombëtar.

4. Vlera minimale e sipërfaqes të zonës së lejuar minerare, vlera minimale e investimeve për realizimin e prodhimit minimal vjetor dhe vlera minimale e prodhimit vjetor për lejet e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit jepen në aneksin 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

ANEKSI 1

TABELA E PËRCAKTIMEVE PËR VLERËN MINIMALE TË SIPËRFAQES SË ZONËS SË LEJUAR TË KËRKIM-ZBULIMIT DHE VLERËN MINIMALE TË INVESTIMIT PËR ÇDO KILOMETËR KATROR TË KËSAJ ZONE, PËR LEJET E KËRKIM-ZBULIMIT SIPAS GRUPEVE TË MINERALEVE

Nr.	Grupi i mineraleve	Vlera minimale e sipërfaqes së zonës së lejuar të kërkim-zbulimit (km ²)	Vlera minimale e investimit për çdo km ² të zonës së lejuar të kërkim-zbulimit	
			Për aktivitetin minerar të kërkimit të mineraleve në periudhën gjatë dy viteve të para të lejes së kërkim-zbulimit (000/euro/km ²)	Për aktivitetin minerar të zbulimit të mineraleve dhe kur kërkohet shtyrje afati (000/euro/km ²)
1	Grupi i mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet	1	20	300
2	Grupi i mineraleve ndërtimore	2	10	100
3	Grupi i mineraleve radioaktive	1	30	400

ANEKSI 2

TABELA E PËRCAKTIMEVE PËR VLERËN MINIMALE TË SIPËRFAQES SË ZONËS SË LEJUAR TË SHFRYTËZIMIT OSE KËRKIM-ZBULIM-SHFRYTËZIMIT, VLERËN MINIMALE TË INVESTIMIT PËR REALIZIMIN E PRODHIMIT MINIMAL VJETOR DHE VLERËN MINIMALE TË PRODHIMIT VJETOR PËR LEJET E SHFRYTËZIMIT DHE LEJET E KËRKIM-ZBULIMI-SHFRYTËZIMIT SIPAS GRUPEVE TË MINERALEVE

Nr.	Grupi i mineraleve		Vlera minimale e sipërfaqes së zonës së lejuar të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit (km ²)	Vlera minimale e prodhimit vjetor për lejet e shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit (tonë/vit ose m ³ /vit)	Vlera minimale e investimeve për realizimin e prodhimit minimal vjetor për lejet e shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit (000 euro/prodhim minimal vjetor)
1	Grupi i mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet				
	a	Mineral kromi	0.02	1000 tonë/vit	60
	b	Mineral bakri	0.02	10000 tonë/vit	300
	c	Mineral FeNi dhe NiSi	0.05	50000 tonë/vit	750
	d	Qymyrguri	0.1	20000 tonë/vit	300
	e	Të gjitha mineralet e tjera të këtij grupi	0.01	1000 tonë/vit	300
2	Grupi i mineraleve ndërtimore				
	a	Mineralet e këtij grupi, që përdoren si materiale dekorative	0.02	1000 m ³ /vit	200
	b	Mineralet e këtij grupi, që përdoren për prodhim materialesh ndërtimi	0.02	10000 m ³ /vit	150
3	Grupi i mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara		0.01	---	150
4	Grupi i mineraleve radioaktive		Përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave e çdo leje minerare	Përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave e çdo leje minerare	Përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave e çdo leje minerare

VENDIM
Nr.366, datë 13.5.2011

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË ERSEKË TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Ersekë, të qarkut të Korçës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 497 (katërqind e nëntëdhjetë e shtatë).

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Ersekë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Ersekë		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
495	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
21-26,61	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
28-30,65-66,72-77,347,496	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
31	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi
32,63,128-133,135-139,142-335,376-382,408,416, 494	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
42,43	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit Sipërfaqja 25.59 ha i është dorëzuar AKKP-së	Në përdorim
46,47,48	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproductive)	Në pronësi

50-60,64,477	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
62	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
79-97	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
98,99	Varrezat publike.	Në pronësi
336-375,383-407,409-415, 417-475,476 (duke përjashtuar sipërfaqet e kthyer), 478-485	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave dhe objekteve të çdo lloji	Në përdorim

VENDIM
Nr.368, datë 14.4.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.424, DATË 2.6.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SISTEMIN E AKREDITIMIT, ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E INSTITUCIONEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 60 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren “Për sistemin e akreditimit, organizimit dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, që i bashkëlidhet vendimit nr.424, datë 2.6.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

I. Në nenin 3 “Detyrat dhe veprimtaritë e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë”, bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 5 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Në kuadër të vlerësimit të programeve në fushat e shkencave të aplikuara dhe të shkencave mjekësore, ekspertët vlerësues së bashku me punonjës të APPAL-së ndërmarrin inspektime të mjediseve laboratorike dhe formimit praktik, si dhe shprehen nëse ato janë në përputhje me kërkesat e programit të studimit.”.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 6.1 me këtë përmbajtje:

“6.1 APAAL-ja ka si funksion garantimin e cilësisë në vijimësi për periudhat ndërmjet dy akreditimeve. APAAL-ja ndërmerr verifikime në terren gjatë procesit të *ranging-ut*. Ekspertët e fushave përkatëse dhe punonjës të APAAL-së kryejnë kontrole të drejtpërdrejta të dokumentacionit, janë të pranishëm në auditorë gjatë periudhës së provimeve dhe diplomimeve, si dhe në organizimin e konferencave shkencore etj.”.

II. Neni 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 6

Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Akreditimit

1. Këshilli i Akreditimit funksionon pranë Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe organizohet sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Numri i anëtarëve të Këshillit të Akreditimit është 11 (njëmbëdhjetë), nga të cilët pesë anëtarë të këtij Këshilli janë pozuar nga institucionet e arsimit të lartë, 3 (tre) ekspertë të fushës, dy nga të cilët janë të huaj, të propozuar nga agjencitë ndërkombëtare të akreditimit, dhe një ekspert, përfaqësues i sektorit privat, një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, një përfaqësues nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës dhe një student i propozuar nga Këshilli Kombëtar Studentor.

3. Ministri i Arsimit dhe Shkencës emëron anëtarët e Këshillit të Akreditimit nga kandidatët e propozuar nga palët e përfaqësuara.

4. Kryetari i Këshillit të Akreditimit përzgjidhet nga kandidatët e propozuar nga ky Këshill. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

5. Këshilli i kryen veprimtaritë e tij në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me rregulloren e tij, e cila miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Vendimi i tyre duhet të jetë profesional, i paanshëm, transparent dhe koherent me vlerësimin e jashtëm të kryer nga ekspertët.

6. Për çështjet, të cilat nuk mbulohen nga ekspertiza e anëtarëve të Këshillit, apo dhe kur gjykohet e nevojshme, Këshilli mund të kërkojë edhe ekspertë apo konsulentë të jashtëm, që të asistojnë për formulimin e vendimeve.

7. Këshilli mbledhet jo më shumë se 9 (nëntë) herë në vit.

8. Anëtari i KA-së, që mungon në 1/3 e mbledhjeve, zëvendësohet.

9. Anëtarët e Këshillit të Akreditimit duhet të respektojnë aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë konfliktin e interesit.

10. Mbledhja e Këshillit të Akreditimit zhvillohet kur marrin pjesë jo më pak se 8 (tetë) anëtarë të tij. Ajo nuk zhvillohet nëse dy ekspertët e huaj nuk janë të pranishëm.

11. Vendimet e Këshillit të Akreditimit merren me shumicë të cilësuar, prej 3/4 të të gjithë anëtarëve.”.

III. Neni 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 9

Pagesa e anëtarëve të Këshillit të Akreditimit

1. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Akreditimit të paguhen për çdo pjesëmarrje në mbledhje, përkatësisht, me 30 për qind dhe 20 për qind të pagës së sekretarit të përgjithshëm në ministri. Anëtarët, ekspertë të huaj, paguhen me një tarifë shërbimi konkurruese, jo më shumë se 600 (gjashtëqind) euro/ditë për çdo pjesëmarrje në mbledhje.

2. Për anëtarët e Këshillit të Akreditimit, ekspertë të huaj, mbulohen shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë për çdo pjesëmarrje në mbledhje.”.

IV. Pas nenit 9 “Pagesa e anëtarëve të Këshillit të Akreditimit” shtohen nenet 9/1 dhe 9/2 me këtë përmbytje:

“Neni 9/1

Pagesa e ekspertëve të huaj në grupin e vlerësimit të jashtëm

Ekspertët e huaj, anëtarë të grupit të vlerësimit të jashtëm institucional dhe të programeve të studimit, paguhen me një tarifë shërbimi konkurruese jo më shumë se 600 (gjashtëqind) euro/ditë për tri ditë. Procesi i një vlerësimi zgjat jo më shumë se tri ditë. Ekspertëve të huaj u mbulohen shpenzimet e udhëtimit e të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë për çdo vlerësim të kryer.

Neni 9/2

Format e vlerësimit të jashtëm të cilësisë

1. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë në institucionet e arsimit të lartë është vlerësim institucional dhe i programeve të studimit.

2. Për vlerësimin e jashtëm institucional të një institucioni të arsimit të lartë në grupin e vlerësimit duhet të jetë, së paku, një ekspert i huaj.

3. Çdo institucion i arsimit të lartë apo program studimi në arsimin e lartë publik dhe privat, përpara lëshimit të diplomave të para, i nënshtrohet procesit të akreditimit të parë. Akreditimi i parë është institucional.”.

V. Pas pikës 2 të nenit 13, shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje:

“2.1. Eksperti duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë një figurë e njohur në fushën përkatëse të shkencës;
- b) të ketë përvojë prej të paktën 5 (pesë) vjetësh në mësimdhënie dhe kërkim shkencor në një nga fushat;
- c) të ketë të paktën gradën shkencore “doktor”;
- ç) të ketë njohuri të gjuhës angleze;
- d) të ketë përvojë në sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë;
- dh) të ketë integritet të lartë personal dhe profesional;
- e) të ketë përvojë ndërkombëtare të fituar përmes studimeve pasuniversitare apo kualifikim shkencor në universitete a qendra kërkimore perëndimore.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.374, datë 18.5.2011

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA AGJENCIA E ADMINISTRIMIT
TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA TE MINISTRIA E MJEDISIT,
PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TË ISH-
SHOQËRISË “LAGUNA E KARAVASTASË” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 29 e 33, paragrafi i parë, të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara te Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, të pasurive të paluajtshme të ish-shoqërisë “Laguna e Karavastasë” sh.p.k., të identifikuar sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ndalohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave që t'i tjetërsojë këto prona.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Pasuritë e shoqërisë “Laguna e Karavastasë” sh.p.k. me sipërfaqe truall 11 792 m² dhe sipërfaqe ndërtese 1216 m², me adresë: Divjakë, Lushnjë, ndarë si më poshtë:

1. Pasuria nr.1396/1, zona kadastrale 1492 (sipërfaqe 540 m² truall);
2. Pasuria nr.1078/3, zona kadastrale 1492 (sipërfaqe 4900 m² + 400 m² ndërtesë);
3. Pasuria nr.1397, zona kadastrale 1492 (sipërfaqe 540 m² truall + 36 m² ndërtesë);
4. Pasuria nr.1089/6, zona kadastrale 1492 (sipërfaqe 1456 m² + 166 m² ndërtesë + 36 m²);
5. Pasuria nr.1089/9, zona kadastrale 1492 (sipërfaqe 2900 m² truall + (375 m² + 105 m² ndërtesë);
6. Pasuria nr.1089/1, zona kadastrale 1492 (sipërfaqe 1456 m² truall + (42 m² + 28 m² + 74 m² ndërtesë).

VENDIM
Nr.375, datë 18.5.2011

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS LIBOFSHË TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Libofshë të qarkut të Fierit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 504 (pesëqind e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Libofshë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Libofshë		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
59-65	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
66-72	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
73-75	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
76-83	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
84,435-458	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
85-132	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
133-139	Shërbim funeral	Në pronësi

227-286	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
290-298	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). Sipërfaqe 235 ha, në ish-NB Hodaj, 147.2 ha, sektori Çiflik dhe 38 ha në Libofshë, janë dorëzuar në AKKP	Në përdorim
299-301, 304-315, 319-321, 330, 338, 352, 357, 365, 372, 382, 386, 397, 403, 407, 410, 414, 418, 422, 428, 434	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive), kanale të treta	Në pronësi
459-481	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
302, 303, 316	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e pyjeve dhe kullotave	Në pronësi

VENDIM
Nr.376, datë 18.5.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS PAPËR TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Papër të qarkut të Elbasanit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 185 (njëqind e tetëdhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1329 (një mijë e treqind e njëzet e nëntë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Papër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-14,1316-1318	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
15-17,1319-1323	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
18-24	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
25-45	Varreza publike	Në pronësi
46-58	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në mbrojtjen civile	Në pronësi
63-69,128-130,136-137,139-140,143-145,148-151,288-292,338-341	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillimin ekonomik	Në pronësi
242-244,248-350,352-354,357-359,361-367,369-375,378-380,384,386-388,191	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). Sipërfaqe 173.97 ha, zona kadastrale 2511 fshati Lugaj, i është dorëzuar AKKP-së	Në përdorim
346,347,351,356,360,368,376,377,382,383,385,389,345,355,381,545,549,552,558,561,562-656 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
670-744,745-783,786-829,832-1022,1024-1057,1327-1329	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në përdorim

VENDIM
Nr.377, datë 25.5.2011

PËR SIGURIMIN E JETËS SË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË DËRGUARA ME MISIONE USHTARAKE JASHTË VENDIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 6 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, të shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me INSIG sh.a., të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që janë me mision ushtarak jashtë vendit.
 2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, i miratuar për vitin 2011.
 3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe INSIG sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.379, datë 18.5.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I KOPSHTIT DHE SHKOLLËS FILLORE PUBLIKE, “KALUDH”, KOMUNA PETRAN, PËRMET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i kopshtit dhe shkollës fillore publike “Kaludh”, komuna Petran, Përmet.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të komunës Petran, Përmet.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 300 (treqind) m² tokë/truall, e vlerësuar me 999 (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë/m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi 299 700 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë.

4. Shpenzimet procedurale të përballohen nga komuna Petran, Përmet.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit 299 700 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë të përballohet nga buxheti i komunës Petran, Përmet.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda muajit qershor 2011.
 7. Komuna Petran, Përmet, të bëjë likuidimin e pronarit brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Komuna Petran, Përmet, si përfituesi për të cilin kryhet procedura e shpronësimit, të kryejë regjistrimin e pasurisë së paluajtshme që shpronësohet pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Përmet.
 9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Përmet dhe komuna Petran, Përmet për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARIT QË DO TË SHPRONËSOHET SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË KOPSHTIT
DHE SHKOLLËS FILLORE PUBLIKE “KALUDH”, KOMUNA PETRAN, PËRMET**

Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja e truallit m²	Çmimi lekë/m²	Vlera e tokës (lekë)	Vlera totale e shpronësimit (lekë)
Llukan Vangjel Theodhori	2057	589/3	300	999	299 700	299 700

Vlera totale e këtij shpronësimi është 299 700 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë.

Shënim. Bazuar në vendimin nr.555, datë 29.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve të trojeve, për qarqet e Beratit, Gjirokastrës, Vlorës e Dibrës, si dhe për qytetet: Bulqizës, Burrel, Klos dhe Vlorë”.

VENDIM
Nr.380, datë 18.5.2011

**PËR NGRITJEN, ORGANIZIMIN DHE MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT
SHKENCOR TË INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 13 të ligjit nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Këshillit Shkencor (KSH) të Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), si organ këshillimor i këtij instituti.
2. KSH-ja drejton punën në ISHP, duke përcaktuar përparësitë dhe duke vlerësuar cilësinë dhe frytshmërinë e punës së kryer. Ky Këshill, gjithashtu, vlerëson vlefshmërinë shkencore e etikën e 3302

programeve të kërkimit apo të ndërhyrjes dhe programet e edukimit në vazhdim në fushën e shëndetit publik, si dhe drejton plane të zhvillimit strategjik, strukturor, teknologjik dhe të burimeve njerëzore në ISHP.

3. Këshilli Shkencor i ISHP-së kryesohet nga drejtori i këtij instituti dhe ka në përbërje këta anëtarë:

- a) një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë;
- b) tre përfaqësues nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, njëri nga të cilët është përfaqësues i Departamentit të Shëndetit Publik;
- c) një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- ç) një përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
- d) një përfaqësues nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
- dh) një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- e) gjashtë anëtarë të tjerë emërohen nga drejtori i ISHP-së, ndërmjet specialistëve të këtij instituti, me gradë dhe/ose titull shkencor.

4. Ministri i Shëndetësisë, kur e sheh të arsyeshme, merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Shkencor të ISHP-së.

5. KSH-ja mbledhet në mënyrë të rregullt, të paktën dy herë në vit, për të analizuar e për të vlerësuar punën e kryer nga ISHP-ja dhe për të drejtuar përparësitë dhe veprimtaritë e ardhshme. KSH-ja mund të mbledhet, për raste të veçanta, dhe nga drejtori i ISHP-së ose nga jo më pak se 1/3 e anëtarëve të tij. Mbledhja hapet dhe zhvillohet kur marrin pjesë jo më pak se 2/3 e anëtarëve.

6. Në mbledhjet e Këshillit Shkencor merr pjesë dhe sekretari i Këshillit, i cili caktohet nga drejtuesi i këtij Këshilli.

